

KALLËZIM PENAL

Datë 22.07.2025

Kallëzuesi: **Aulon Kalaja**, i biri i Yllit dhe i Rakipes, i datëlindjes 05.08.1989, i martuar, me shtetësi shqiptare, lindur në Krujë, banues në Tiranë, me numër telefoni 00355 69 23 00 035, me adresë Tiranë, Rruga “Petro Marko, 21.

Vepra penale: “*Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve*”, parashikuar nga paragrafi i dytë i nenit 326 i Kodit Penal, i kryer në bashkëpunim sipas nenit 25, 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal.

“*Grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga paragrafi i parë dhe i dytë i nenit 333/a të Kodit Penal.

Baza ligjore: Neni 75/a dhe 283 i Kodit të Procedurës Penale.

Drejtuar

Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

I/E nderuar Prokuror,

Me datë 11.05.2025 janë zhvilluar zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Unë kam garuar në rradhët e kandidatëve për deputet të vendosur në listën preferenciale për Partinë Demokratike në Qarkun Durrës. Ka qenë kjo arsyeja që e kam ndjekur nga afër ndër të tjera edhe procesin e numërimit të votave, personalisht në Fushë-Krujë dhe në Krujë dhe përmes personave të besuar të mi në KZAZ të tjera të Qarkut Durrës.

Përgjatë numërimit të votave dhe pas përfundimit të procesit të numërimit kam marrë në vijimësi të dhëna që numërues të caktuar nëpër KZAZ të ndryshme të Qarkut Durrës, në bashkëpunim të paraplanifikuar me kandidatë të caktuar të listës preferenciale, falsifikonin fletët e votimit dhe materialet zgjedhore, me qëllimin kriminal për të rritur fiktivisht kandidatët organizatorë të kësaj ndërmarrje kriminale. Të dhënat e marra në mënyrë konfidenciale prej vetë numëruesve apo vëzhguesve të caktuar më bënë me dije për disa mënyra të ndryshme manipulimi të rezultatit të votimit përgjatë numërimit të votave preferenciale. Në mënyrë të përmblodhur po i rendis si më poshtë:

- 1) *Plotësimi nga numësues të caktuar me “+” apo me “x” në kuadratin e një kandidati të caktuar në listë në votat ku votuesi nuk kishte përzgjedhur asnjë kandidat por kishte votuar vetëm Partinë Demokratike;*
- 2) *Bërja e pavlefshme qëllimisht e votave të kandidatit Z. Aulon Kalaja, duke shënuar me “+” apo me “x” në kuadratin e një partie tjetër apo në kuadratin e një subjekti tjetër preferencial në votat ku zgjedhësi kishte votuar vetëm kandidatin Z. Aulon Kalaja;*
- 3) *Marrja e votave në të cilat zgjedhësit kishin votuar një kandidat që kishte marrë shumë pak vota në Qark dhe që ndërkohë nuk kishte treguar më interes për të ndjekur votimin vetë*

apo me persona të besuar dhe numërimi i tyre sikur të ishin vota të një kandidati të caktuar në listen preferenciale të Partisë Demokratike;

- 4) *Marrja e votave të kandidatit Z. Aulon Kalaja dhe numërimi tek votat e një kandidati tjetër dhe pasqyrimi në procesverbalet e rezultateve të numërimit sikur ato vota ishin të kandidatit tjetër, me qëllim që ai të rritej fiktivisht në numër.*

Me qëllim që të verifikoheshin këto të dhëna të përfutuara gjatë dhe pas procesit të numërimit dhe me qëllim që të verifikoheshin të dhënat që kam perceptuar drejtpërdrejtë përgjatë procesit të numërimit në KZAZ Krujë dhe Fushë-Krujë, kam kërkuar nga KQZ materialet filmike të procesit të numërimit të votave në Qarkun Durrës, duke dashur të hartoja edhe kërkesën për rinumërimin e votave dhe hapjen e kutive të votimit. Pasi e kam marrë materialin me qindra orë filmimi nga ana e KQZ, kam nisur të bëj kqyrjen dhe të verifikoj çfarë ka ndodhur në KZAZ të caktuara gjatë numërimit.

Në mbrëmjen e datës 24.05.2025 KQZ më ka vënë në dispozicion pamjet filmike dhe kam patur më pak se 4 ditë kohë që t'i shoh me ekipin tim zgjedhor, pasi kaq ditë kohë kisha në dispozicion për ushtrimin e ankimit administrative. Është e vetekuptueshme nuk kam arritur t'i analizoj dhe kqyr të gjitha pamjet por vetem një pjesë të KZAZ nr. 21 dhe një pjesë fare të vogël të pamjeve të KZAZ nr. 20. Nga ajo analizë më ka rezultuar se deri më tani se ka falsifikim të materialeve zgjedhore nga numëruesit, sikurse tregohet në vijim:

1. Kutia 1334 nje kandidat ka perfituar ne menyre te padrejte 15 vota.
2. Kutia 1358/1 nje kandidat ka perfituar ne menyre te padrejte 4 vota.
3. Kutia 1359 nje kandidat ka perfituar ne menyre te padrejte 2 vota.
4. Kutia 1362 nje kandidat ka perfituar ne menyre te padrejte 3 vota.
5. Kutia 1366 nje kandidat ka perfituar ne menyre te padrejte 2 vota.
6. Kutia 1369/1 nje kandidat ka perfituar ne menyre te padrejte 3 vota.
7. Kutia 1372 nje kandidat ka perfituar ne menyre te padrejte 1 vote.
8. Kutia 1372/2 nje kandidat ka perfituar ne menyre te padrejte 4 vota.
9. Kutia 1375/2 nje kandidat ka perfituar ne menyre te padrejte 2 vota.
10. Kutia 1384/1 nje kandidat ka perfituar ne menyre te padrejte 8 vota.
11. Kutia 1409 nje kandidat ka perfituar ne menyre te padrejte 1 vote.
12. Kutia 1420 nje kandidat ka perfituar ne menyre te padrejte 5 vota.
13. Kutia 1467 nje kandidat ka perfituar ne menyre te padrejte 1 vote.
14. Kutia 1469/1 nje kandidat ka perfituar ne menyre te padrejte 9 vota.
15. Kutia 1469/2 nje kandidat ka perfituar ne menyre te padrejte 14 vota.
16. Kutia 1517 nje kandidat ka perfituar ne menyre te padrejte 1 vote.
17. Kutia 1282 nje kandidat ka perfituar ne menyre te padrejte 1 vote.
18. Z. Aulon Kalaja në kutinë e diaspores I janë hequr padrejtësisht 3 vota.
19. Z. Aulon Kalaja në kutinë 1327 I është hequr padrejtësisht 1 vote.
20. Z. Aulon Kalaja në kutinë 1359 I është hequr padrejtësisht 1 votë.
21. Z. Aulon Kalaja në kutinë 1361 I është hequr padrejtësisht 2 vota.
22. Z. Aulon Kalaja në kutinë 1379 I është hequr padrejtësisht 1 votë.
23. Z. Aulon Kalaja në kutinë 1380 I është hequr padrejtësisht 1 votë.

24. Z. Aulon Kalaja në kutinë 1420 I janë hequr padrejtësisht 2 vota.
25. Z. Aulon Kalaja në kutinë 1469/1 I është hequr padrejtësisht 1 votë.
26. Z. Aulon Kalaja në kutinë 1369/2 I janë hequr padrejtësisht 3 vota.
27. Z. Aulon Kalaja në kutinë 1309 I është hequr padrejtësisht 1 votë.
28. Z. Aulon Kalaja në kutinë 1317 I është hequr padrejtësisht 1 votë.
29. Kutia 1352, një kandidat rezulton me **4 vota** preferenciale ndërkohë që në tabelën përmbledhëse të rezultatit zgjedhor figuron me **0 vota**. Në po këtë kuti një kandidat rezulton me **31 vota** preferenciale ndërkohe që në tabelën përmbledhëse të rezultatit zgjedhor figuron me **36 vota**.
30. Kutia 1358/1, një kandidat rezulton me **10 vota** preferenciale ndërkohë që në tabelën përmbledhëse të rezultatit zgjedhor figuron me **7 vota**. Një kandidat rezulton me **11 vota** preferenciale, ndërkohe që në tabelën përmbledhëse të rezultatit zgjedhor figuron me **10 vota**. Në po këtë kuti një kandidat rezulton me **31 vota** preferenciale, ndërkohë që në tabelën përmbledhëse të rezultatit zgjedhor figuron me **35 vota**.
31. Kutia 1361, z.Aulon Kalaja rezulton me **4 vota** preferenciale ndërkohë që në tabelën përmbledhëse të rezultatit zgjedhor figuron me **2 vota**. Një kandidat rezulton me **3 vota** preferenciale ndërkohë që në tabelën përmbledhëse të rezultatit zgjedhor figuron me **2 vota**. Një kandidat rezulton me **1 votë** preferenciale ndërkohë që në tabelën përmbledhëse të rezultatit zgjedhor figuron me **0 vota**. Një kandidat rezulton me **20 vota** preferenciale ndërkohë që në tabelën përmbledhëse të rezultatit zgjedhor figuron me **25 vota**.
32. Kutia 1347, një kandidat rezulton me **17 vota** preferenciale, ndërkohë që në tabelën përmbledhëse të rezultatit zgjedhor figuron me **18 vota**.
33. Kutia 1349/1 një kandidat rezulton me **9 vota** preferenciale, ndërkohë që në tabelën përmbledhëse të rezultatit zgjedhor figuron me **7 vota**. Në po këtë kuti një kandidat rezulton me **9 vota** preferenciale, ndërkohë që në tabelën përmbledhëse të rezultatit zgjedhor figuron me **4 vota**. Në po këtë kuti një kandidat rezulton me **4 vota** preferenciale ndërkohë që në tabelën përmbledhëse të rezultatit zgjedhor figuron me **3 vota**. Me po kete kuti një kandidat rezulton me nje vote me teper se ne realitet.
34. Kutia 1362, një kandidat rezulton me **14 vota** preferenciale, ndërkohë që në tabelën përmbledhëse të rezultatit zgjedhor figuron me **11 vota**. Në po këtë kuti një kandidat rezulton me **12 vota** preferenciale, ndërkohë që në tabelën përmbledhëse të rezultatit zgjedhor figuron me **15 vota**.
35. Kutia 1364/01, një kandidat rezulton me **4 vota** preferenciale, ndërkohë që në tabelën përmbledhëse të rezultatit zgjedhor figuron me **3 vota**. Një kandidat rezulton me **1 votë** preferenciale ndërkohë që në tabelën përmbledhëse të rezultatit zgjedhor figuron me **0 vota**. Një kandidat rezulton me **14 vota** preferenciale, ndërkohë që në tabelën përmbledhëse të rezultatit zgjedhor figuron me **15 vota**.
36. Kutia 1348, një kandidat rezulton me **5 vota** preferenciale, ndërkohë që në tabelën përmbledhëse të rezultatit zgjedhor figuron me **6 vota**. Në po këtë kuti një kandidat rezulton me **10 vota** preferenciale ndërkohë që në tabelën përmbledhëse të rezultatit zgjedhor figuron me **9 vota**. Gjithashtu, A
37. Kutia 1359/00, një kandidat rezulton me **3 vota** preferenciale, ndërkohë që në tabelën përmbledhëse të rezultatit zgjedhor figuron me **2 vota**. Në po këtë kuti një kandidat

rezulton me **17 vota** preferenciale, ndërkohë që në tabelën përmbledhëse të rezultatit zgjedhor figuron me **19 vota**. Në po këtë kuti një kandidat rezulton me **9 vota** preferenciale, ndërkohë që në tabelën përmbledhëse të rezultatit zgjedhor figuron me **10 vota**.

Këto të dhëna janë mbi këqyrjet që kam bërë unë në shumë orë filmimi të marrë nga KQZ në punën e kryer nga grupet e numërimit.

Me datë 17.06.2025 KAS i KQZ vendosi të pranojë pjesërisht kërkesën e Partisë Lëvizja e Legalitetit dhe të hapë 275 kuti votimi të KZAZ 21 dhe 22 dhe gjithashtu edhe 85 kuti nga votimi jashtë Shqipërisë të diasporës për llogari të Qarkut Durrës (*shih njoftimin e KQZ të kapur "Screenshot" nga telefoni dhe të printuar bashkëlidhur kallëzimit penal*). Pavarësisht se matematika e këtyre numrave do të duhet të sillte për rinumërim gjithsej 360 kuti, në faqen zyrtare elektronike të KQZ del se do të numërohen vetëm 290 kuti për Qarkun Kurrës në datë 04.07.2025, ora 12:00 (*shih foton e kapur "screenshot" nga telefoni dhe të printuar dhe të bashkëlidhur kallëzimit penal*). Ndërkohë në këtë moment tregohet që secili nga kandidatët për deputet të Partisë Demokratike të listës preferenciale kishin vota më pak se ishin votuar nga zgjedhësit, tregohet se vetëm një kandidati të caktuar votat i ishin numëruar nga numëruesit e këtyre grupeve të numërimit ndryshe nga çfarë kishin votuar zgjedhësit, duke i shtuar **30 vota**.

Me datë 17.06.2025 KAS në seancë plenare vendosi të pranojë pjesërisht kërkesën e Partisë Lëvizja e Legalitetit dhe të hapë 275 kuti votimi të KZAZ 21 dhe 22 dhe gjithashtu edhe 85 kuti nga votimi jashtë Shqipërisë të diasporës për llogari të Qarkut Durrës (*shih njoftimin e KQZ të kapur "Screenshot" nga telefoni dhe të printuar bashkëlidhur kallëzimit penal*). Sjell në vëmendje të Kolegjit Zgjedhor se nuk ka asnjë vendim të zbardhur dhe të njoftuar të KAS kundrejt nesh si persona drejtpërdrejtë të interesuar se si u artikulua KAS për hapjen e kujt kutie, sipas kujt kriteri, pse kjo vendimmarrje tërësisht selektive e të tjera dilemma pasigure që kanë shoqëruar këtë proces në administruar tërësisht jo në përputhje me ligjin zgjedhor. Nuk e kemi të qartë se cilin vendim të ndërmjetëm të KAS kanë patur në dispozicion pjesa ekzekutive e nëpunësve të KQZ kur janë ngritur grupet e rinumërimit dhe se cilat ishin udhëzimet për zbatimin e këtij vendimi të ndërmjetëm të mbetur enigmë. Interesimit tonë në KQZ nuk iu adresua kurrë një përgjigje dhe se merrnim dijeni se cila kuti do hapet vetëm kur hapej konkretisht nga grupet e rinumërimit. Qartazi veprohej në informalitet, sikurse do të konstatohet nga relatimi i fakteve në vijim.

Pavarësisht se matematika e këtyre numrave, të marra dijeni vetëm nga publikimi i KQZ si lajm, do të duhet të sillte për rinumërim gjithsej 360 kuti, në faqen zyrtare elektronike të KQZ del se do të numërohen vetëm 290 kuti për Qarkun Kurrës në datë 04.07.2025, ora 12:00 (*shih foton e kapur "screenshot" nga telefoni dhe të printuar dhe të bashkëlidhur kallëzimit penal*). Nuk ka asnjë vendim të ndërmjetëm të KAS që të tregojë se cilët anëtarë e ndryshuan numrin nga 360 në 290, pse ndodhi kjo, cilat kuti u vendosën se do të hapen, cilat kuti u vendosën se nuk do të hapen dhe se çfarë ndryshoi ndërkohë që ndryshoi edhe vendimi i ndërmjetëm i marrë më parë. Këmbënguljes sonë për informim nga KAS apo KQZ nuk iu adresua asnjë zgjidhje, ndërkohë që grupet e rinumërimit nuk jepnin asnjë sqarim se pse vendosej të hapej një kuti dhe jo një tjetër. Qartësisht

veprohej në një informalitet haptazi të pabazuar në ligjin zgjedhor dhe nuk kuptohej se cili ishte autoriteti vendimmarrës i këtyre ngjarjeve që ndodhnin me grupet e rinumërimit. Ndërkohë në këtë moment tregohet që secili nga kandidatët për deputet të Partisë Demokratike të listës preferenciale kishin vota më pak se ishin votuar nga zgjedhësit, tregohet se vetëm një kandidati të caktuar votat i ishin numëruar nga numëruesit e këtyre grupeve të numërimit ndryshe nga çfarë kishin votuar zgjedhësit, duke i shtuar **30 vota**.

Në orën 15:30 rezulton se faqja zyrtare e KQZ nxjerr si rezultat paraprak nga numërimi se kandidatë të caktuar kishin vota më pak në procesverbalet e numërimit nga sa e kanë votuar zgjedhësit dhe nga sa ndodheshin në kuti dhe disa të tjerë kishin më shumë vota në procesverbalet e numërimit nga sa kishin në kuti, duke shënuar një nga kandidatët numrin **77 vota** më shumë (*shih foton e kapur “screenshot” nga telefoni dhe të printuar dhe bashkëlidhur apelit*).

Për çudi, ndërkohë që rinumërimi tregonte në vijimësi rritjen artificiale dhe përmes falsifikimit të organizuar të materialeve zgjedhore nga numëruesit ndër grupe të numërimit të KZAZ 21 dhe 22, KQZ përditëson të dhënat në faqe zyrtare, duke u pasqyruar se me datë 04.07.2025, ora 18:30 janë numëruar 141 kuti nga 154 kuti që do të numërohen. Sërisht nuk ka asnjë vendim të ndërmjetëm të KAS që të tregojë se cilët anëtarë e ndryshuan numrin 290 në 154, pse ndodhi kjo, cilat kuti u vendosën se do të hapen, cilat kuti u vendosën se nuk do të hapen dhe se çfarë ndryshoi ndërkohë që ndryshoi edhe vendimi i ndërmjetëm i marrë më parë. Këmbënguljes sonë për informim nga KAS apo KQZ nuk iu adresua asnjë zgjidhje, ndërkohë që grupet e rinumërimit nuk jepnin asnjë sqarim se pse vendosej të hapej një kuti dhe jo një tjetër. Qartësisht veprohej në një informalitet haptazi të pabazuar në ligjin zgjedhor dhe nuk kuptohej se cili ishte autoriteti vendimmarrës i këtyre ngjarjeve që ndodhnin me grupet e rinumërimit.

Edhe pse ishte e qartë se kandidatë të caktuar në bashkëpunim me numërues të caktuar kanë vepruar me keqbesim kriminal për falsifikimin e rezultateve të votimit, në një mënyrë krejt jotransparente dhe të pazbardhur deri më sot, numri i kutive të votimit ndryshon nga 360 në 290 më tej në 154 dhe më në fund, me datë 04.07.2025, ora 23:30, faqja zyrtare elektronike e KQZ tregon se janë rinumëruar 152 nga 152 kuti votimi, duke e mbyllur sakaq procesin e rinumërimit për Qarkun Durrës. Asgjë për ndryshimin e numrit të kutive të caktuara dhe të vendosura për rinumërim, nga 360, në 290, në 154 dhe në 152, nga ana e KQZ nuk është e qartë, sikurse u përsërit dy herë më lart. Asnjë informacion nuk na u bë me dije se si u administrua dhe nga cili u administrua ky proces haptazi i parregullt ligjërisht.

Si përfundim rezulton se, nga rinumërimi gjithsej i 152 kutive të votimit në Qarkun Durrës në KZAZ 21 dhe 22 rezultoi se ka kandidatë me **88 vota** të falsifikuara, me **33 vota** të falsifikuara dhe me **3 vota** të falsifikuara. Nga ana tjetër ka kandidatë në listat preferenciale që grupet e numërimit i kanë hequr votat që ua kanë besuar zgjedhësit, konkretisht me -11, -12, -1 dhe -24 vota.

Ndërkohë me datë 07.07.2025 KAS vendosi përfundimisht se nuk do të ketë numërim kutish në Qarkun Durrës më shumë se sa 152, sikurse u tregua më lart. Ju sjellim në vëmendje se në seancën

publike të datës 07.07.2025, pasi kandidati Aulon Kalaja kishte arritur të këqyrte edhe 8 kuti të tjera votimi të parinumëruara nga KAS dhe të këqyrura rishtazi nga ai, kandidati Aulon Kalaja i bëri me dije KAS numrin e secilës kuti të këqyruar dhe problematikat e konstatuara nga ato, nga ku rezultojnë 28 vota të falsifikuara sërisht në materialet zgjedhore nga numëruesit dhe në bashkëpunim me kandidatët e begatuar kriminalisht. Asnjë përshtypje nuk i bëri KAS parashtrimi i këtyre fakteve dhe me vendimmarrje të ndërmjetme KAS unanimisht vendosi rrëzimin e kërkesës për rinumërimin e pjesës tjetër të kutive.

Sjellim në vëmendje se kjo vendimmarrje e ndërmjetme vjen në kundërshtim flagrant me nenin 141 të Kodit Zgjedhor. Në të njëjtën kohë u vendos përfundimisht miratimi i tabelës së rezultateve zgjedhore për Qarkun Durrës, duke ndryshuar pjesërisht rezultatin e miratuar nga Komisioneri sipas rezultateve të përditësuara nga rinumërimi i KAS i vetëm 152 kutive, edhe pse sërisht në të kishte 28 vota të falsifikuara të këqyrura nga kandidati Aulon Kalaja në materialet filmike të paraqitura nga KQZ. Kaq mjafton për të konkluduar se anëtarët e KAS, në një votim të treguar nga ato publikisht në seancë 5 vota me 0, kanë miratuar një rezultat të falsifikuar zgjedhor dhe me dijeni të plotë, duke shpërdoruar detyrën.

Ndërkohë 313 kuti të tjera janë miratuar nga Komisioneri Zgjedhor dhe KAZ pa asnjë transparencë dhe me dyshime të arsyeshme dhe të provuara se ka në to materiale zgjedhore të falsifikuara sistematikisht nga e njëjta skemë kriminale e organizuar ndërmjet numëruesve dhe kandidatëve të begatuar kriminalisht. Asnjë e dhënë nuk u qartësua, as edhe për transparencë, se çfarë ndodhi me numrin 360 që u shndërrua rrugës 290; çfarë ndodhi me numrin 290 që u shndërrua rrugës në 154; dhe çfarë ndodhi me numrin 154 që u shndërrua rrugës në 152, duke u mbyllur me kaq. Ndërkohë që u tregua krejt qartë se KQZ konstatoi drejtpërdrejtë disa krime zgjedhore të ndodhura dhe të kryera nga kandidatët e listave preferenciale që rezultonin me më shumë vota se çfarë ishin votuar nga zgjedhësit në bashkëpunim me numëruesit. KQZ (KAS) kishte akoma më shumë prova për të vendosur rinumërimin e të gjitha kutive në Qarkun Durrës dhe, krejt ndryshe nga çdo logjikë normale dhe çdo pritshmëri legjitime, ato vendosin uljen me 209 kuti të numrit të kutive të paravendosur për t'u hapur, duke i dhënë fund nevojës për transparencë dhe legjitimitet zgjedhor dhe duke mbyllur bashkë me procesin e rinumërimit për Qarkun Durrës edhe zbardhjen e krimeve zgjedhore.

Në kushtet kur KQZ dhe KAS nuk ka vepruar deri më sot për të kallëzuar *ex officio* veprat penale të konstatuara gjatë procesit të rinumërimit, sipas nenit 283 të Kodit të Procedurës Penale, jam i detyruar të veproj përmes këtij kallëzimi penal. Prokuroria e Posaçme ka tashmë detyrimin kushtetues që të hetojë dhe të zbardhë të vërtetën për krimet zgjedhore të konsumuara nga kandidatët e listës preferenciale në bashkëpunim me secilin prej numëruesve që ka pranuar të ushtrojë me marrëveshje detyrën zyrtare në mënyrë kriminale, me rezultatin e falsifikimit të votave dhe të materialeve zgjedhore. Ju sjell në vëmendje se ndaj anëtarëve të KAS në KQZ kam paraqitur kallëzim penal në SPAK me datë 08.07.2025 për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për gjithësa u parashtrua më lart.

Sjell në vëmendje të Prokurorisë së Posaçme se kam bindjen e krijuar nga perceptimi drejtpërdrejtë i gjithë procesit zgjedhor në Qarkun e Durrësit dhe posaçërisht gjatë procesit të numërimit se asgjë nuk paraqet gabime njerëzore dhe episodike të numëruesve në këto fakte të referuara. Vepra penale e falsifikimit të votave dhe materialeve zgjedhore nga ana e kandidatëve të listës preferenciale në bashkëpunim me numëruesit bashkëekzekutorë të tyre ka qenë një plan dhe strategji e paraplanifikuar dhe e vënë në jetë sistematikisht nëpër tavolinat e numërimit të zgjedhjeve të 11 Majit 2025. Është pikërisht kjo arsyeja që kam bindjen se veprat penale të referuara si më lart nuk janë krime zgjedhore episodike dhe të palidhura me njëra-tjetrën por janë tablo me emërues të përbashkët të venies në jetë të një plani kriminal të planifikuar ndërmjet më shumë se tre persona dhe me organizatorë kandidatët që janë begatuar me vota në mënyrë të falsifikuar. Ndaj kallëzimi penal i drejtohet Prokurorisë së Posaçme, pasi vepra penale e parashikuar nga neni 326 i Kodit Penal është kryer në bashkëpunim të posaçëm, konkretisht në formën e grupit të strukturuar kriminal, sipas nenit 28/4, 333/a dhe 334 të Kodit Penal. Kjo do të thotë se, sipas nenit 135, 148, 148/dh të Kushtetutës dhe nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, kompetente për ushtrimin e ndjekjes penale dhe gjykimin e kësaj çështje janë organet e posaçme të drejtësisë penale.

Ju sjell në vëmendje se disa prej veprimeve hetimore që Ju duhet të kryeni me qëllim zbadhjen e fakteve penale të referuara janë:

- Identifikimi i numëruesve në Qarkun Durrës;
- Kqyrja e materialit filmil me video-audio zyrtar të KQZ për veprimtarinë e grupeve të numërimit në KZAZ të Qarkut Durrës, pasi aty tregohen veprimet konkludente me dashje të numëruesve për falsifikimin e materialit zgjedhor dhe identifikohen numëruesit bashkëpunëtorë me kandidatët për deputetë të listës preferenciale për begatimin kriminal të të cilëve ato veprojnë;
- Pyetja e kandidatëve të listës preferenciale dhe numëruesve, edhe atyre që identifikohen me shkelje të ligjit edhe atyre që nuk evidentohen të kenë të tilla;
- Ekspertimi grafik dhe kriminalistik i bojës së stilolapsave që kanë shënjuar fletët e pavlefshme të votimit;
- Ekspertimi grafik dhe kriminalistik i bojës së stilolapsave që kanë shënjuar votën për subjektin politik dhe kandidatin preferencial në fletët e votimit të cilat janë të kandidatëve që tregohen se kanë marrë përmes numëruesve vota të falsifikuara në procesverbalet e numërimit;
- Hetimi i lidhjeve kompromentuese të numëruesve të identifikuar si bashkëpunëtorë dhe kandidatëve të listës preferenciale të identifikuar si bashkëpunëtorë në kryerjen e veprave penale të falsifikimit të materialit zgjedhor në grup të strukturuar kriminal;
- Administrimin e materialeve respektive zgjedhore të secilës KZAZ të Qarkut Durrës.

Sjell në vëmendje të Prokurorisë së Posaçme se po në këto përfundime dhe konstatime ka ardhur KQZ edhe përmes rinumërimit në Qarkun Dibër, Tiranë dhe Fier. I kam ndjekur nga media rezultatet e falsifikimit sistematik të numërimit të votave të listave të kandidatëve preferencialë por nuk i njoh me detaje asnjë prej këtyre proceseve dhe se dijeninë e kam vetëm nga media. Si

qytetar i Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 283 të Kodit të Procedurës Penale, marr iniciativën t’Ju sjell në vëmendje dhe t’Ju kërkoj që hetimin e këtij kallëzimi ta zgjeroni edhe me këto fakte penale të referuara dhe të ndodhura në Qarkun Dibër, Tiranë, Fier.

Qëllimi unik dhe i patjetërsueshëm i kësaj iniciative qytetare është ndëshkimi i kriminelëve zgjedhor dhe i krimit zgjedhor, me printshmërinë e madhe se institucioni Juaj mund të realizojë në mënyrë strategjike vendosjen e kulturës së ndëshkueshmërisë së krimeve zgjedhore, në mënyrë që zgjedhjet e ardhshme të mos kriminalizohen më prej bashkëpunimit kriminal kandidat dhe numërues.

Gjeni bashkëlidhur printime të fotove “*screenshot*” të njoftimit dhe faqe zyrtare të KQZ të përditësuara në kohë të ndryshme.

Me shpresën dhe besimin se kallëzimi penal do të marrë vëmendjen e duhur Tuajën dhe me konsideratën më të lartë,

AULON KALAJA